

ABU SEMAN
NR. Prot. 1050
dt 30/11/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 21 Datë 16/11/2017

Për

miratimin e lejes, për përdorim të burimit ujore të perroit të Tomorriçes në lumin Devoll, për prodhim hidroenergjie nepermjet hec Mivasi -1 nga subjekti "TOER ENERGY" sh.p.k në Bashkinë Skrapar Qarku Berat.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumentave shoqeruse, afatit të vlefshmerise, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Basenit Ujore si dhe Vendimi të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencise së Basenit Ujore" Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e lejes, për përdorim të burimit ujore të perroit të Tomorriçes në lumin Devoll, për prodhim hidroenergjie nepermjet hec "Mivasi -1" nga subjekti "TOER ENERGY" sh.p.k në Bashkia Skrapar Qarku Berat.

HEC MIVASI 1

Perroit të Tomorriçes në lumin Devoll

Vepër e marrjes

X=4436596 Y=4502505 Z=463 mrd

- Prurja mesatare 2.39 m³/sek.
- Prurja llogaritore: 3.1 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.23 m³/sek.

Godina e centralit

X=4435282 Y=4506942 Z=380m

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhet të plotësohen kushtet e mëposhme:

- Të mos cenohet furnizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të prespektives.
- Të zbatohet grafikun për vaditje në kohë (dite) dhe në sasi (l/s) për çdo vit të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendore dhe atë Qendrore.
- Të respektohet grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit.
- Të respektohet rregullat ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet AB USeman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN



KRYETARI I K.B.U SEMAN



Baki Bala